

Bashkia Pukë - Kontrata e shërbimit të pastrimit



Bashkia Pukë ofron shërbimin e pastrimit me Drejtorinë e Shërbimeve Publike (Sektori i Menaxhimit të Mbetjeve) në 2 zona shërbimi me kosto 11,287,000 mije lek/vit



Venddepozitimi në Fushë Qarrit



2 mjete teknologjike vetshkarkuese i transportojnë mbetjet për asgjesimin fundor në venddepozitimin e **Fushë-Qarrit**

Gjatë **vitit të fundit deri në tetor 2021**, Bashkia Pukë ka grumbulluar **1,400 ton** mbetje të ngurta urbane nga zonat ku ofron shërbimin e grumbullimit të mbetjeve.



Bashkia Puka

Mbetjet e ngurta urbane grumbullohen **të përziera** në 142 kontenierë **1.1m³**, pronë e bashkisë.



Bashkia Pukë **monitoron realizimin e shërbimit të pastrimit** çdo ditë me inspektorët e saj



Inspektorët e bashkisë **hartojnë raportet ditore** dhe i dorëzojnë në drejtorinë e shërbimeve publike



ZONAT E SHËRBIMIT

Zona 1 – NjA Pukë

- ✓ Grumbullim dhe transportin e mbetjeve të përziera urbane
- ✓ Fshirje manuale/ me fshesë të rrugëve kryesore dhe dytësore
- ✓ Mirëmbajtje e shesheve dhe trotuareve të rrugëve kryesore
- ✓ Larje me presion të rrugëve kryesore
- ✓ Lagje të rrugëve kryesore dhe dytësore gjatë 6 muajve të vitit (prill- shtator)


Zona 2 – NjA Qerret, NjA Qelez, NjA Gjegan, NjA Rrape



- ✓ Grumbullim dhe transportin e mbetjeve të përziera urbane
- ✓ Larje me presion të rrugëve kryesore
- ✓ Lagje të rrugëve kryesore dhe dytësore gjatë 6 muajve të vitit (prill- shtator)

Ne, Ju informojmë se:



NË NJA PUKË


Grumbullimi dhe transporti i mbetjeve të ngurta urbane kryhet **3 ditë të javës** në orarin  **06:00 – 12:00**

Fshirja me fshesë e rrugëve kryesore kryhet çdo ditë të javës në orarin  **06:00 – 16:00** dhe **dytësore** në orarin  **06:00 – 16:00**

Qytetarët ftohen nga Bashkia të hedhin mbetjet e ngurta urbane në kontenierët e përcaktuara nga bashkia gjatë gjithë harkut kohor



NË NJA QERRET, QELEZ, GJEGJAN, RRAPE

Grumbullimi dhe transporti i mbetjeve të ngurta urbane kryhet në **3 ditë të muajit** në orarin  **06:00 – 14:00**



Qytetarët ftohen nga Bashkia të hedhin mbetjet e ngurta urbane në kontenierët e përcaktuara nga bashkia gjatë gjithë harkut kohor

 **Ne, Ju informojmë se:**

Këshilli Bashkiak Pukë ka miratuar paketën fiskale të tarifave dhe taksave vendore për vitin 2020

Çdo familje në **Bashkinë Pukë** duhet të paguajë  **1,500 lek/vit tarifë pastrimi** në zonën 1 dhe  **750 lek/vit tarifë pastrimi** në zonën 2 së bashku me faturën e ujësjellësit UK- Pukë.

Familjet me status të veçantë paguajnë  **nën vlerën 750 lek/vit tarifë pastrimi**, ndërsa **invalidët nuk tarifohen.**

Bashkia Pukë parashikoi të mbledhë për vitin 2020  **5902 mijë lek/vit**, prej të cilave realizoi  **73% të tyre**, duke mbuluar me **40%** koston e shërbimit të pastrimit.